


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8019
E shtunë, 22 mars 2025
Çmimi 0.50

Vota përmes postës, LV-ja dorëzon ankesë në Gjykatën Supreme

FACE 5



Na ndiqni edhe në:


www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

E DHIMBSHME, THAÇI PËRKULET PARA VARRIT TË BABAIT: ERDHA I FUNDIT, BABË...

FACE 4-5




Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, për të dytën herë me radhë brenda pak ditësh po zhvillon një vizitë në Kosovë. Thaçi ka mbërritur në vendlindje disa ditë pas vdekjes së babait të

tij. Ai në përcjellje të rreptë të sigurisë ka vizituar të premtën varrin e babait në Burojë. I vetëm pranë varrit, Thaçi vendosi një kurorë lulësh, e ku mbishkrimi ishte mjaft prekës. "Te varri yt

erdha i fundit, babë. Para meje erdhën mijëra qytetarë. Së shpejti, dorë me dorë, do t'i falënderoj të gjithë. Të qoftë i lehtë dhe i Kosovës!", thuhet në mbishkrimin e vendosur në kurorë

OSMANI: VENDIMIN NËSE DO TË GAROJ PËR MANDATIN E DYTË DO TA MARR BAZUAR NË INTERESIN E KOSOVËS

F.3



FORMIMI I QEVERISË SË RE, TAHIRI THOTË SE KA QENË EDHE MË HERËT SITUATA E TILLË, KUR POSTI I KRYEMINISTRIT I KA TAKUAR PARTISË OPOZITARE

F.7



KOSOVA PËRMBYLL DY PROGRAME ME VLERË 180 MILIONË EURO

F.8

SPORT



RAHMANI DHE EMËRLLAHU: PRESIM TË NGREHEMI NË LIGËN B

F.6

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renovamt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi thotë se ShBA-ja dhe Ukraina do ta nënshkruajnë së shpejti marrëveshjen për minerale

WASHINGTON, 21 MARS - Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se Shtetet e Bashkuara do ta nënshkruajnë së shpejti një marrëveshje për minerale dhe burime natyrore me Ukrainën.

Trumpi tha për gazetarë në Shtëpinë e Bardhë mbremjen e së enjtes se përpjekjet e tij për ta arritur paqen në mes të Ukrainës dhe Rusisë janë duke shkuar "shumë mirë", pasi këtë javë bisedoi me liderët e dy vendeve të përfshira në luftë. "Jemi duke ecur shumë mirë me Ukrainën dhe Rusinë. Dhe një nga gjërat që po bëjmë është nënshkrimi shumë shpejt i një marrëveshjeje me Ukrainën në lidhje me mineralet e rralla", tha Trumpi. Derisa Trumpi po i bënte këto komente, forcat ruse sulmuan infrastrukturën civile në Odesa, duke shkaktuar dëme dhe duke plagosur tre persona, përfshirë një vajzë, tha guvernatori rajonal. "Armiku i

sulmoi fuqishëm me dronë Odesën dhe rajonin", tha guvernatori Oleh Kiper. "Ka dëme në infrastrukturën civile, duke përfshirë një ndërtesë të lartë banimi, një qendër tregtare dhe dyqane", shkroi ai në Telegram.

Ndërkohë, thuhet se në rajonin Kursk të Rusisë forcat ukrainase sulmuan stacionin e shpërndarjes së gazit në Sudzha. Media e pavarur Sota publikoi një foto në Telegram që shfaq një zjarr të madh.

Zyrtarët e qeverisë ukrainase nuk janë deklaruar për këtë sulm. As Moskë nuk e raportoi incidentin.

Stacioni ishte pika e vetme përmes së cilës kalonte gasi rus në rrugën e tij drejt Evropës, deri kur Ukraina refuzoi të zgjasë një marrëveshje tranziti në janar.

Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, urdhëroi të enjten ukrainasit në territoret e pushtuara të Ukrainës të



marrin pasaportë ruse deri më 10 shtator ose të largohen. Ultimatumi vlen për ukrainasit në rajonet e pushtuara Donjeck, Luhansk, Herson dhe Zaporizhja, tha në X ish-ministri i Ekonomisë i Ukrainës, Tymofiy Mylovanov. Këtë javë Trumpi zhvilloi bisedime të ndara me Putinin dhe presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelensky, në

përpjekje për ta ndërmjetësuar arritjen e një armëpushimi mes dy vendeve fqinje.

Ai nuk arriti ta sigurojë një armëpushim të plotë 30-ditor, por bisedimet bënë që Putini të pajtohet për t'i ndaluar sulmet ruse ndaj infrastrukturës energjetike për 30 ditë. Pas bisedimeve me Trumpin, Zelensky tha se ai gjithashtu do ta pranonte një pauzë të tillë.

"Ne duam që kjo (luftë) të përfundojë, dhe mendoj se po ecim mjaft mirë në këtë drejtim", tha Trumpi.

Ukraina dhe Shtetet e Bashkuara u pajtuan në fillim të këtij muaji për ta përfunduar një marrëveshje gjithëpërfshirëse për zhvillimin e burimeve të saj minerale. Përpjekjet për të finalizuar marrëveshjen u prishën më 28 shkurt pas një debati të ashpër midis Trumpit dhe Zelenskyt në Shtëpinë e Bardhë.

Trumpi dhe Zelensky ranë dakord më 19 mars të punojnë së bashku për t'i dhënë fund luftës së Rusisë në Ukrainë, gjatë një bisede telefonike që Shtëpia e Bardhë e përshkroi si të "shkëlqyer".

Nuk është e qartë nëse kushtet e marrëveshjes për mineralet kanë ndryshuar. Një version i mëparshëm nuk përfshinte garancitë e sigurisë për Ukrainën që Zelensky kishte kërkuar.

Qeveria turke e paralajmëron opozitën të mos bëjë thirrje për protesta pas arrestimit të Imamoglut

ANKARA, 21 MARS - Qeveria e Turqisë e ka paralajmëruar të premtën partinë kryesore opozitare kundër thirrjeve "të jashtëligjshme" për protesta në rrugë në lidhje me arrestimin e kryetarit të Stambollit, Ekrem Imamoglu.

Mijëra njerëz protestuan në dy ditët e fundit në gjithë vendin. Ministri i Brendshëm i Turqisë, Ali Yerlikaya, tha se 53 njerëz janë arrestuar dhe 16 oficerë policorë janë lënduar në protestat që filluan në kampuse universitare, selinë qendrore të komunës së Stambollit dhe në pjesë të tjera të vendit të enjten.

Imamoglu, rivali kryesor politik i presidentit Recep Tayyip Erdogan, u arrestua të mërkurën nën akuzat për korrupsion dhe mbështetje të një grupi terrorist. Partia kryesore opozitare e Imamoglut, Partia Popullore



Republikane (CHP), ka thënë se arrestimi i tij është i nxitur politikisht dhe u ka bërë thirrje njerëzve të dalin për të protestuar ligjërisht.

Arrestimi i Imamoglut është dënues nga liderët evropianë.

Yerlikaya dhe ministri i Drejtësisë, Yilmaz Tunc, i

kritikuan thirrjet për veprim nga lideri i CHP-së, Özgür Özel, duke i quajtur "të papërgjegjshme". "Grumbullimi dhe marshimi në protestë janë të drejta themelore. Por thirrja për të dalë në rrugë për një hetim të vazhdueshëm ligjor është e paligjshme dhe e papranueshme", tha Tunc në X të

premtën.

Tunc tha se gjykata është vendi për t'iu përgjigjur çdo procesi ligjor dhe bëri thirrje për qetësi, duke shtuar se "gjyqësori i pavarur dhe i paanshëm" po vlerëson çështjen.

Turqia i ndaloi protestat për katër ditë pas arrestimit të Imamoglut, i cili prin para Erdoganit në disa prej sondazheve në Turqi.

Të enjten u zhvilluan demonstrata në Ankara, Izmir dhe Stamboll, si dhe në provinca të tjera në të gjithë vendin, derisa policia ngriti barrkada në disa rrugë kryesore.

Erdogan i ka hedhur poshtë kritikën e opozitës duke i cilësuar "skena teatrale" dhe "slogane" që e largojnë vëmendjen nga gabimet e saj të brendshme.

Duke folur në tubimin kryesor në Stamboll të enjten mbrëma,

lideri i CHP-së, Özel, u përgjigj: "Hej Erdogan, gjëja që të trembë më shumë janë rrugët. Tani jemi në rrugë, në shesh. Vazhdoni të keni frikë".

Që nga ndalimi i Imamoglut, shumë mbështetës kanë kërkuar veprime më konkrete dhe të organizuara nga CHP-ja.

Imamoglut, 54 vjeç, u arrestua derisa CHP-ja po përgatitej për ta shpallur atë kandidat presidencial të dielën. Partia u ka kërkuar njerëzve jashtë partisë të votojnë për të në kutitë e votimit të vendosura në të gjithë vendin, si shenjë e rezistencës publike.

Zgjedhjet e ardhshme presidenciale në Turqi duhet të mbahen më 2028, por Erdogan, 71 vjeç, mund të shpallë zgjedhjet të parakohshme për ta shmangur kufizimin dy-mandatesh nëse vendos të garojë përsëri.

Aeroporti i Londrës mbyllet si pasojë e zjarrit, anulohen qindra fluturime

LONDËR, 21 MARS - Aeroporti Heathrow i Britanisë së Madhe do të jetë i mbyllur tërë ditën e premtën, për shkak të ndërprerjes së rrymës si pasojë e një zjarri, duke bërë që qindra fluturime të anulohen. Të paktën 1.350 fluturime për dhe nga Heathrow janë prekur nga mbyllja e aeroportit për ditën e premtë, sipas gjurmuesit të fluturimeve FlightRadar 24. "Për të ruajtur sigurinë e udhëtarëve dhe

kolegëve tanë, nuk kemi zgjidhje tjetër veçse ta mbyllim Heathrow-n për të gjithë ditën; tha aeroporti. "Udhëtarët nuk duhet të udhëtojnë drejt aeroportit në asnjë rrethanë derisa të rihapet ai".

Brigada e Zjarrfikësve të Londrës solli 10 zjarrfikëse dhe rreth 70 zjarrfikës për ta vënë nën kontroll zjarrin disa orë pasi zjarri shpërtheu kur një transformator në një

nënstacion elektrik mori flakë në përfundim të Londrës të enjten në mbremjen.

Heathrow është një nga aeroportet më të ngarkuara në botë për udhëtime ndërkombëtare.

Janari i këtij viti ishte më i ngarkuari, me më shumë se 6.3 milionë udhëtarë, një rritje prej mbi 5 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Janari ishte gjithashtu muaji i 11-të radhazi me një



mesatare prej mbi 200.000 udhëtarësh në ditë.

Mbyllja e përkohshme e Heathrow sjell në mendje vonesat e vitit 2023 në

aeroportet britanike kur sistemi i kontrollit ajror i Mbretërisë së Bashkuar pësoi defekt, duke ngadalësuar ngritjet dhe uljet e avionëve në mbarë vendin në njërin nga ditët më të ngarkuara të vitit për udhëtime.

Heathrow tha në një komunikatë se do të njoftojë mbi operacionet e tij sapo të ketë më shumë informata për kohën e rikthimit të energjisë elektrike.

E DHIMBSHME, THAÇI PËRKULET PARA VARRIT TË BABAIT: ERDHA I FUNDIT, BABË...

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, për të dytën herë me radhë brenda pak ditësh po zhvillon një vizitë në Kosovë. Thaçi ka mbërritur në vendlindje disa ditë pas vdekjes së babait të tij. Ai në përcjellje të rreptë të sigurisë ka vizituar të premtën varrin e babait në Burojë. I vetëm pranë varrit, Thaçi vendosi një kurorë lulësh, e ku mbishkrimi ishte mjaft prekës. “Te varri yt erdha i fundit, babë. Para meje erdhën mijëra qytetarë. Së shpejti, dorë me dorë, do t’i falënderoj të gjithë. Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës!”, thuhet në mbishkrimin e vendosur në kurorë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 21 MARS - Tri ditë pas ceremonisë së varrimit të babait, Hashim Thaçit i është lejuar sërish ardhja në Kosovë. Thaçi të premtën paradite ka aterruar në Prishtinë, e nga aty ka shkuar drejt Burojës për ta vizituar varrin e babait që vdiq të dielën që shkoi në QKUK pas një sëmundje të gjatë. Kjo është vizita e dytë në Kosovë e Hashim Thaçit brenda një intervali të shkurtër kohor.

Ish-presidenti i vendit ka ardhur në Prishtinë më 13 mars ku për disa orë ka qëndruar në QKUK për ta vizituar babanë që po trajtohej aty, që më vonë u kuptua se ishte në ditët e fundit të jetës.

Mbrojtja e tij ka kërkuar që Thaçi të vijë për varrim të martën në Burojë, por kjo vizitë s’është aprovuar nga gjykata. Ardhja i është lejuar vetëm pasi ka përfunduar e pamja treditëshe që është mbajtur në sallën e sporteve në Skenderaj.

I përcjellë me masa të rrepta sigurie në një veturë të EULEX-it, e shoqëruar edhe nga vetura të Policisë së Kosovës, ish-



presidenti Thaçi ka vizituar varrin e babait të tij dhe pastaj ka qëndruar në shtëpinë e familjes në Burojë përreth dy orë nga ku ka dalë duke përshëndetur të pranishmit me një gisht që është vërejtur brenda automjetit me xhama të errët.

Nën masa të rrepta të sigurisë, Thaçi vizitoi varrin e babait të tij. I vetëm pranë varrit, Thaçi vendosi një kurorë lulësh, e ku mbishkrimi ishte mjaft prekës. “Te varri yt erdha i fundit babë.

Para meje erdhën mijëra qytetarë. Së shpejti, dorë me dorë, do t’i falënderoj të gjithë. Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës”, thuhet në mbishkrimin e vendosur në kurorë.

E derisa qëndroi te varri i babait, disa qytetarë ishin mbledhur pak metra më larg tij, të cilët i shprehën ngushëllime Thaçit për humbjen e babait. Ndërkaq Thaçi para se të hynte në veturë përshëndeti ata qytetarë dhe ngriti dorën grusht, duke përcjell mesazhin se është i fortë

dhe drejtësia do të triumfojë. Gazeta “Epoka e re” ka marrë vesh nga disa burime se kjo vizitë është aprovuar me disa kushte specifike. Thaçi të premtën do të qëndrojë në Kosovë, brenda objekteve të EULEX-it, ku edhe do ta kalojë natën, ndërsa të shtunën do ta vizitojë familja për t’i shprehur ngushëllime për vdekjen e babait, e më pas ai do të kthehet në Hagë.

Thaçi po përballet me dy procese gjyqësore në Gjykatën Speciale në Hagë dhe është në paraburgim në qytetin holandez prej vitit 2020. Në rastin e parë Thaçi akuzohet kinse për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, bashkë me ish-zyrtarë të tjerë të lartë të Kosovës, si Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Vitin e kaluar ndaj Thaçit u ngrit një aktakuzë e re për përpjekje të paligjshme për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve në rastin e parë gjyqësor.

Thaçi është deklaruar i pafajshëm në dy rastet gjyqësore.



DY REXHEPAT!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

1. REXHEP HOXHA: Rexhep Hoxha ishte shkrimtar shqiptar për fëmijë nga Kosova, që jetoi plotë 90 vite, nga viti 1929 - 2019. Lindi në qytetin ku e ka burimin intelektualizmi dhe patriotizmi shqiptar, në Gjakovën e Bajram Currit dhe kaloi në amshim në qytetin më të madh kosovar që ishte në të njëjtën kohë strehë e horrave antikombëtarë por edhe të idealistëve të paepur shqiptarë në krye të Papërsëritshmin Bacë Adem Demaçi, në Prishtinë. Pikërisht me Bacë Adem Demaçin shumë herë e kemi vizituar shkrimtarin e madh shqiptar që tërë jetën dhe veprimtarinë i ka kushtuar shtresës dhe shpresës më të padjallëzuar, më të sinqertë dhe investimit më të shëndoshë në shoqëri, fëmijëve! Realisht, edhe Baca Adem shumë i ka dashur fëmijët. Shkrimtari dhe patrioti shqiptar Rexhep Hoxha ishte klasiku i fundit i letërsisë shqipe për fëmijë dhe të rinj, i patejkaluar deri më tani, fanar i përjetshëm për shkrimtarët e rinj të këtij zhanri. Mund të gjeni shkrimtarë të talentuar për fëmijë por nuk i kanë të renditura në mënyrë harmonike të gjitha kubëzat e mozaikut të domosdoshme ta kompletojnë personalitetin e një shkrimtari sikur që ishte, njerëzorja, atdhedashuria, sinqeriteti, thjeshtësia, pasuria shpirtërore, refuzimi i mediokritetit, mosnënshtrimi ndaj autoritetit politik dhe shtetëror antikombëtar, respektimi deri në përlujë ndaj

veprave dhe personaliteteve të përkushtuara kombëtare. Të gjitha këto i kishte Rexhep Hoxha e që nuk llogaritej as e pranueshme e as normale për kohën kur shumë intelektualë shqiptarë të kohës ishin vënë në shërbim të politikës antikombëtare prandaj gëzonin të gjitha privilegjet pushtetore, deri në kohën kur ia dorëzuan shpirtin e zi djallit jugosllav apo serb. Rexhep Hoxha ia dorëzoi shpirtin e bardhë engjëllit mbrojtës të popujve të robëruar në vitin 2019. Ishte shpërfillës me të keqin por qortues me ata që i donte dhe i çmonte. Kemi takuar shumë personalitete me Bacën Adem Demaçi por asnjëri nuk e kishte karizmën e Rexhep Hoxhës. Kur e ngacmonin me qëllim për t'ia liruuar adrenalinën, vetëm sa nuk na rrihte por kur ndaheshim na "urdhëronte" ta vizitojmë më shpesh, pa shpresuar se ndaj nesh do të bënte lëshime. Ministria e Kulturës e Kosovës ndanë Çmime Jetësore për Letërsi që bartin emrat e atyre që pjesën dërrmuese të jetës dhe veprimtarisë ia kanë kushtuar aktivitetëve antikombëtare dhe që qençe i kanë shërbyer regjimeve jugosllave dhe serbe. Paradoxalisht, pas çlirimit të Kosovës, këta kuislingë shqipfolës janë rehabilituar, tash si "patriotë" shqiptarë dhe kosovarë duke zënë vende dhe pozita me rëndësi në të gjitha fushat e jetës. Shihni sot kush janë pronarë të mediave, kush

janë në diplomaci, në qeveri, në Kuvend të Kosovës, në Presidencë, pasardhës të antikombëtarëve të djeshëm, urryes të UÇK-së, të burgosurve politikë shqiptarë, mohues të Bacë Adem Demaçit dhe të çdo gjëje kombëtare. Kundër tyre ishte shkrimtari patriot Rexhep Hoxha, deri sa kaloi në amshim. Ministria për Kulturë e Kosovës shumë rrallë ia ka qëlluar kur ka ndarë Çmime Jetësore për Letërsi, ose e ka shpërblyer krijuesin e gabuar apo të pamerituar, ose krijuesit të mirë dhe të merituar i ka ndarë çmimin në emrin e personalitetit që me asgjë nuk ka shkuar me fituesin e çmimit. Kështu vepruan edhe me shkrimtarin dhe patriotin idealist shqiptar - Rexhep Hoxhën duke i ndarë Çmimi "Azem Shkreli". Çmimi në atë kohë kapte vlerën e 5000 eurove, vlerë e madhe për standardin kosovar e sidomos për një pensionist siç ishte Rexhep Hoxha. Ndërtimi njerëzor, kombëtar dhe moral i Rexhep Hoxhës në asnjë mënyrë nuk e lejonte ta pranonte këtë çmim dhe Rexhep Hoxha e dha një arsytim pse e refuzonte këtë çmim. Ai tha se nuk mund ta pranonte një çmim që ishte emërtuar me emrin e një letrari që duart i kishte të përgjakura me gjakun e patriotëve shqiptarë, si agent i UDB-së, duke e cilësuar si të tillë Azem Shkrelin, emrin që paradoksalisht dhe turpërisht e mbanë njëri ndër çmimet

kryesore për Letërsi që sot e ndanë Ministria për Kulturë e Kosovës. Të rinjtë nuk kanë informata për të kaluarën e Azem Shkreli, të moshuarit dhe këta që e mirëmbajnë këtë çmim janë pjesë e kënetës antinjerëzore dhe antikombëtare. Prandaj Rexhep Hoxha mbeti i madh sepse kishte parime të pathyeshme njerëzore, kombëtare, profesionale dhe morale.

2. REXHEP QOSJA: Rexhep Qosja është hulumtues, kritik letrar, shkrimtar dhe, mbi të gjitha, sipas meje është dijetar, erudit. Është anëtar i ASHAK-ut që udhëhiqet nga një kryetar me të kaluar të dyshimtë kombëtare dhe politike. Sikur që janë edhe disa anëtarë të kësaj korporate që asgjë ose fare pak ka bërë për Kosovën në planin intelektual, politik, kombëtar apo afirmativ. Në mjekësi do të thoshin se është një kulturë e mbjellë me parazitë për t'u caktuar më lehtë diagnoza. Rexhepi nr.2 pra, Qosja ka lindur në Vuthaj të Malit të Zi në vitin 1936 dhe jeton në Prishtinë, Kosovë. Si dijetar është i pakundërshtueshëm, si letrar nuk është i keq, si politikan është skajshmërisht jokompetent, madje gjatë rrugëtimit politik, gjithmonë në shërbim të tjerëve, asnjëherë njëshi, vetëm ka shkaktuar përçarje dhe ka bërë dëme. Nuk ka asgjë më keq se kur një dijetar i nënshtrimit mediokritetit paramilitar politik. Këtë pikërisht e bëri

Rexhep Qosja para zgjedhjeve të fundit kur me një ferman publik kërkoi të votohet LV-ja dhe Albin Kurthi sikur që në të njëjtën kohë sulmoi brutalisht ata që i sollën lirinë Kosovës, e shpallën pavarësinë dhe e bënë shtetin. Nuk ka asgjë më e rëndë, degraduese dhe batakçillëk kur një dijetar del publikisht dhe kërkon vota korruptive për çiftat e agimbahtirave, halilthaçave, dimalbashave, dejonamihajlave, hajnrullahçekove, arbenpiftijave dhe banuesve therë të kënetës kombëtare dhe parapolitike. Dhe, dora e zgjatur e mëshirës së shtetit për rrogëtarët e vet veptori shpejt, shumë më shpejt se posta e Alia Expressit. Ministria për Antikulturë i ndau Robit të vet çmimin e parë për Letërsi, i mbuluar me 10.000 euro, vlerë monetare. Rexhepi nr.2 për dallim nga Rexhepi nr. 1 i pranoi edhe çmimin e sidomos 10.000 zemra të eurove.

Rexhepi nr. 1 nuk pranoi asnjë privilegj apo favor prej asnjë pushteti apo regjimi, kurse Rexhepi nr. 2 i pranoi të gjitha privilegjet dhe favorët e të gjitha pushteteve dhe regjimeve, që nga ai i Josip Broz Titos e deri te ky i Albin Kurthit. Prandaj nuk kisha asnjë mëdyshje se cili do të jetë Rexhepi nr. 1 e cili Rexhepi nr. 2. Rexhep Hoxha do të jetë gjithmonë në "Kujtimet" e "Lugjeve të Verdha", si një kolos njerëzor, kombëtar dhe moral kurse Rexhep Qosja do të jetë një "Picimul" "që" vdekjen e pretë prej syve të tillë sikur që është nënshtrimi ndaj një mediokriteti politik.

VOTA PËRMES POSTËS, LV-ja DORËZON ANKESË NË GJYKATËN SUPREME

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 MARS - Lëvizja Vetëvendosje ka njoftuar se, duke qenë e bindur dhe duke e dëshmuar me fakte e prova të pakontestueshme skemën kriminale të manipulimit me vota përmes postës, të premtën brenda afatit ligjor ka dorëzuar në Gjykatën Supreme ankesën e saj në lidhje me këtë proces. "Lëvizja Vetëvendosje! edhe njëherë kërkon anulimin e 18.933 votave të LDK-së të ardhura në mënyrë të manipuluar, rivotimin me postë dhe largimin nga lista të kandidatëve që kanë marrë vota në mënyrë të pakrahasueshme më shumë përmes votimit me postë sesa në vendvotime në Kosovë dhe moszëvendësimin e tyre me anëtarë të tjerë të LDK-së. Vetëm përmes pranimit të ankesës sonë mund të rivendoset legjitimiteti i zgjedhjeve në Kosovë. Faktet kanë dëshmuar për një vjedhje industriale të votave dhe presim nga Gjykata Supreme që të korrektojë vendimin e padrejtë të PZAP-së e të marrë vendimin e duhur për ta parandaluar një precedent të tillë në të ardhmen", ka

njoftuar Lëvizja Vetëvendosje. Më 17 mars LV-ja i ishte drejtuar Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, duke kërkuar të anuloheshin votat me postë që ka marrë Lidhja Demokratike e Kosovës, duke thënë se ato ishin "manipuluar" dhe duke kërkuar rivotim me postë. Por, PZAP e hodhi poshtë ankesën e LV-së.


LV-ja tha se shpreson që Supremja ta "korrektojë vendimin e padrejtë" të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës lidhur me votimin me postë.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Gjykata Supreme ka afat prej pesë ditësh nga paraqitja e ankesës, që të vendosë për të.

Më 15 mars Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur rezultatet përfundimtare për votimet e 9 shkurtit, por vetëm pasi të kenë përfunduar afatet për ankesë në supreme, Komisioni mund ta certifikojë rezultatin e zgjedhjeve – duke i hapur rrugë formimit të institucioneve të reja.

Sipas rezultatit përfundimtar, LV-ja prin me mbi 390.000 vota apo 42.30 për qind.

E dyta ka dalë Partia



Demokratike e Kosovës (PDK) me mbi 190.000 vota, apo 20.95 për qind, pasuar nga LDK-ja me mbi 170.000 mijë vota, apo 18.27 për qind. Në vendin e katërt është koalicioni mes Aleancës për

Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismës Socialdemokrate me mbi 66.000 vota apo 7.06 për qind. Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, ka siguruar mbi 39.000 vota apo

4.26 për qind. Me këto përqindje, LV-ja i ka siguruar 48 ulëse në Kuvendin e Kosovës, PDK-ja, 24 sosh, LDK, 20 vende, Lista Serbe nëntë vende dhe koalicioni AAK-Nisma, tetë vende.

AKTAKUZË NDAJ TRE PERSONAVE PËR KRIME LUFTE NË KOSOVË



PRISHTINË, 21 MARS - Prokuroria Speciale e Kosovës njoftoi se ka ngritur aktakuzë ndaj tre të pandehurve për krime lufte kundër popullatës civile.

Të pandehurit, sipas Prokurorisë, janë R. V. dhe M. V., të nacionalitetit serb, dhe A. Ç., i nacionalitetit boshnjak, të cilët akuzohen se kanë marrë pjesë në vrasjen e 14 civilëve shqiptarë në komunën e Pejës. "Hetimet kanë vërtetuar se të pandehurit si pjesëtarë rezervë të Policisë të stacionit policor në Pejë, në bashkëkryerje me pjesëtarë të forcave policore serbe, gjatë kohës së luftës në

Kosovë, në fshatin Ozdrim, Komuna e Pejës dhe në fshatrat përreth regjionit të Pejës, kanë kryer vrasje, dëbim, shkatërrim të pasurisë dhe keqtrajtim ndaj popullsisë civile shqiptare që nuk ishin të përfshirë në luftë, me ç'rast u vranë 14 civilë të nacionalitetit shqiptar", u tha në njoftim.

Prokuroria tha se ka propozuar që ndaj tre të akuzuarve gjykimi të mbahet në mungesë, pasi ata gjenden në arrati. Sipas ligjeve në Kosovë, gjykimi në mungesë mund të zhvillohet vetëm me kusht që prokuroria dhe gjykata t'i kenë

shteruar të gjitha mjetet për ta siguruar praninë e të akuzuarve.

Më 26 dhjetor të vitit të kaluar Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar me 15 vjet burgim Çedomir Aksiqin për akuzën krime lufte kundër popullsisë civile, të kryera nga janari deri në maj të vitit 1999 në territorin e komunës së Shtimes, përkatësisht në fshatrat Reçak, Malopolc dhe Petrovë.

Ky është vendimi i parë për krime lufte i marrë në mungesë, bazuar në Kodin e ndryshuar të Procedurës Penale të vitit 2022.

Raporti i autopsisë: Të gjitha viktimat e zjarrit në Koçan vdiqën nga asfiksioni

PRISHTINË, 21 MARS - Dekani i Fakultetit të Mjekësisë në Shkup, Svetozar Antoviq dhe udhëheqësi i Institutit të Mjekësisë Ligjore, Aleksandar Stankov, kanë njoftuar të premtën se, pas ngjarjes tragjike në Koçan, për një kohë shumë të shkurtër janë kryer 59 autopsi dhe identifikime të të vdekurve.

Sic u theksua në konferencën për medie, u formuan gjashtë ekipe, të përbëra nga ekspertë të mjekësisë ligjore, patologë

dhe ekipe të MPB-së. "Të gjitha viktimat u zbuluan se kishin vdekur nga asfiksia e dhunshme, e shkaktuar drejtpërdrejt nga zjarri. Pritet që të gjitha raportet e autopsisë të përfundojnë deri në fund të marsit. Veshjet dhe të gjitha sendet e gjetura tek të vdekurit ndodhen në Institutin dhe do t'i kalojnë Prokurorisë", u tha në konferencë.

Sipas Stankov, menjëherë pas marrjes së informacionit për zjarrit, të gjithë punonjësit e Institutit kanë

arritur në vendet e tyre të punës për vetëm një orë dhe është hartuar plan për veprime të duhura. "Qëllimi ishte përfundimi i shpejtë dhe cilësor i autopsisë që filluan në mbrëmjen e 16 marsit dhe përfunduan në mëngjesin e 18 marsit, si dhe për të siguruar identifikim të saktë", theksoi Stankov.

Ai së bashku me dekanin e fakultetit u shprehën ngushëllime familjarëve të të ndjerëve dhe u uruan shërim të shpejtë të lënduarve që ndodhen në spital.



Haxhiu thotë se kanë dërguar qindra dosje për korrupsion: Prokuroria asnjë veprim

PRISHTINË, 21 MARS - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, i ka reaguar Prokurorisë Speciale pas bastisjeve që u kryen dje në Ministrinë e Bujqësisë nën dyshimet për keqpërdorime të detyrës zyrtare, falsifikim të dokumenteve dhe për mashtrim në prokurim publik. "Qindra dosje me dyshime për korrupsion e keqpërdorime të

detyrës zyrtare janë dërguar në prokurori nga Qeveria jonë. Prokuroria asnjë veprim. Asnjë bastisje nëpër institucione pas atyre denoncimeve që i kemi bërë. Heshtje totale. Por mjafton një lajm diku në portale, e menjëherë vrapohet me bastisje në Ministri. Portale e gazeta ka pasur tash e sa kohë, por çështja është a kishte ato kohë Prokurori?!

Përgjigjen e dimë të gjithë", ka shkruar ajo në "Facebook". Haxhiu ka thënë se keqpërdorimet, abuzimet e shkatërrimet e ndërmarrjeve publike sikurse edhe pasurimi i pajustificueshëm i zyrtarëve të lartë ka ndodhur para syve të Prokurorisë. "Drejtësia s'duhet të jetë selektive. Aq më pak spektakël", ka shkruar Haxhiu.



KONJUFCA: MODELI FETAR SHQIPTAR VËSHTIRË TË GJENDET DIKU TJETËR

PRISHTINË, 21 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, mori pjesë në tryezën "Dialogu ndërjetar sipas modelit shqiptar", e cila u mbajt në premtën në Katedralen "Nëna Terezë" në Prishtinë. Gjatë fjalës së tij kryetari Konjufca tha se modeli shqiptar i bashkëjetesës fetare duhet të promovohet në mënyrë akademike dhe organizative, duke qenë se është një nga fenomenet e rralla në shoqëritë e sotme. "Unë besoj vërtet që ekziston një model origjinal shqiptar i bashkëjetesës fetare, një model i cili është vështirë të gjendet diku tjetër. Historia e gjatë e popullit tonë të përvuajtur tregon se në asnjë moment nuk ka pasur një konflikt i cili ka bazë fetare. Kombi ynë është bartës i katër feve të mëdha monoteiste dhe është vërtet për t'u studiuar se si nuk mund



të gjendet asnjë tronditje te populli ynë, i cili është me bazë fetare që rrallë keni parë te popujt tjerë", tha Konjufca. Kryekuvendari Konjufca shtoi se ky model duhet të studiohet nga akademikët dhe të shpërndahe nëpër botë për të treguar këtë pasuri që ka populli shqiptar. Siç tha kreu i Kuvendit, modeli i dytë i kësaj vlere ndër

shqiptarë është bashkëjetesa që është ndërtuar me shekuj, të cilën ai e konsideroi meritë të të gjithëve, por më shumë të besimtarëve shumicë. "Nuk ka vend në botë i cili mund të ketë rehati, paqe, stabilitet dhe prosperitet nëse shumica është kundër kësaj. Nëse shumica është kundër një gjëje të tillë gjithmonë do të ketë jorehati, do të ketë dhunë dhe tensione",

tha Konjufca. Sipas kreut të Kuvendit, dialogu fetar nuk do të gjente vend më të përshtatshëm për t'u hapur si temë diskutimi se në Kosovë, por edhe në vendet kudo që jetojnë shqiptarët. "Feja nuk është bërë asnjëherë pengesë për realizimin e synimeve kombëtare, siç ishte rasti i shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 1912, por edhe

shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008", tha kryetari Konjufca, duke shtuar se në historinë kombëtare ka plot prijës fetarë që kanë luftuar për çlirim nga okupatorët.

Konjufca tha se shqiptarët e besimeve të ndryshme jo që jetuan në paqe mes vete, por u bënë edhe strehë për ata që ndiqeshin, që edhe u shpëtuan, siç ishte rasti me hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore e kjo, sipas tij, është dëshmia më e lartë e këtij virtyti të popullit shqiptar.

Në tryezë morën pjesë të ftuar të shumtë, personalitete të ndryshme vendore e ndërkombëtare.

Tryeza u organizua nga shoqata "Drita", me mbështetje nga Dioqeza Katolike e Prizrenit, Bashkësia Islame e Kosovës dhe Komuna e Prishtinës.

ANTON QUNI NUK E PËRJASHTON KOALICIONIN ME LV-NË: PERSONALISHT NUK KAM VIJA TË KUQE



PRISHTINË, 21 MARS - Anton Quni nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nuk e ka përjashtuar mundësinë e një koalicioni me Lëvizjen Vetëvendosje. "Unë personalisht nuk kam vija të kuqe, përkundër të gjitha atyre frustrimeve dhe konfuzioneve që janë shkaktuar, por këto janë çështje që diskutohen në organet më të larta të LDK-së", ka thënë Quni për rtv21. Megjithatë, sipas tij, për t'u arritur një gjë e tillë duhet të arrihet implementimi i programit të tyre qeverisës. "Janë

shumë të panjohura të cilat do të mund të diskutohen. Ne e kemi një program politik me të cilin u kemi bërë ofertë qytetarëve dhe për të cilin ne besojmë se Kosovën e nxjerr nga ky qorrsohak. E nëse ne arrijmë si parti politike ta implementojmë programin tonë qeverisës, atëherë duhet të merren në konsideratë të gjitha opsionet", ka thënë Quni. Derisa Quni komentoi kërkesën e ndërkombëtarëve për një qeveri stabile, ai ka thënë se qeverinë e ardhshme e presin procese komplekse.

"Kërkesa e ndërkombëtarëve është shumë e arsyeshme nga fakti se në agjendën e cilësdo qeveri do të jenë disa prioritetet esenciale për të ardhmen e Kosovës, jo vetëm të Kosovës, por edhe për rajonin më gjerë. Prandaj duke filluar nga partia fitues, e cila do ta ketë mundësinë ta ndërtojë koalicionin deri tek opsionet e tjera, duhet ta kenë parasysh këtë fakt, se një qeveri e radhës duhet të jetë kredibile, për faktin se do të menaxhojë procese shumë komplekse për të ardhmen e Kosovës", ka deklaruar Quni.

Munguan tre ish-deputetë, dështon sërish seanca për gazin lotsjellës në Kuvend

PRISHTINË, 21 MARS - Në mungesë të të akuzuarve Pal Lekaj, Donika Kadaj Bujupi dhe Besa Baftiu, të premtën ka dështuar të mbahet seanca për gazin lotsjellës. Në seancë është paraqitur vetëm e akuzuara Albulena Haxhiu, e cila deklaroi se dëshiron mbrojtës sipas

detyrës zyrtare. Ndërsa në mungesë të të akuzuarve Lekaj, Kadaj-Bujupi dhe Baftiu gjyqtari i rastit, Bujar Ahmeti ndërpreu seancën e së premtës dhe të njëjtën e caktoi për një datë tjetër, raporton "Betimi për Drejtësi". Gjyqtari Ahmeti njoftoi se për të akuzuarin Lekaj dhe Baftiu

gjykata nuk ka dëshmi se e kanë pranuar ftesën e që, sipas njoftimit, janë shpërngulur nga adresa. Ndërsa për të akuzuarin Kadaj-Bujupi gjykata ka dërguar ftesë të rregullt, por e njëjta nuk i është përgjigjur kësaj ftese. Po ashtu, gjyqtari Ahmeti njoftoi palët se nga

mbrojtësi i të akuzuarit Lekaj, avokati Musa Damati, përmes një parashtrere të dorëzuar kësaj gjykate, ka kërkuar nga gjykata shtyrjen e kësaj seance. Senca e datës 21 nëntor 2025 kishte dështuar në mungesë të akuzuarve Pal Lekaj, Besa Baftiu dhe Donika Kadaj-Bujupi.



Osmani: Vendimin nëse do të garoj për mandatin e dytë do ta marr bazuar në interesin e Kosovës

PRISHTINË, 21 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të premtën se vendimin për të garuar apo jo edhe për një mandat tjetër do ta marrë "vetëm duke pasur parasysh interesin" e Kosovës dhe të qytetarëve të saj.

Mandati pesëvjeçar i presidentes Osmani përfundon më 7 prill të vitit 2026. "Nga viti i ardhshëm do të diskutojmë për këtë çështje. Gjatë gjithë karrierës sime politike kam punuar gjithmonë duke pasur parasysh interesin e Kosovës dhe qytetarëve të saj. Asnjëherë asnjë vendim imi politik nuk është bazuar në kalkulime për atë se ku do të jem unë, por vetëm se ku do të jetë Kosova dhe qytetarët e saj", tha Osmani për medie në Prishtinë.

Njohësit e çështjeve politike kanë thënë se koalicionet eventuale pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit mund ta përfshijnë edhe çështjen e pozitës së presidentit të Kosovës. Posti i presidentit të Kosovës



është kryesisht ceremonial, por luan rol udhëheqës në politikën e jashtme dhe si komandant i forcave të

armatosura. Demush Shasha nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane tha se, në rast se partia fituese e

zgjedhjeve Lëvizja Vetëvendosje do ta formojë qeverinë e re me ndonjë nga partitë opozitare shqiptare, atëherë çështja e

postit të presidentit të Kosovës do të jetë në tavolinën e "pazareve politike".

Osmani e mori mandatin më 4 prill të vitit 2021, pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare që u mbajtën më 14 shkurt 2021. Me partinë e saj Guxo, që ka qenë në listë të përbashkët me Vetëvendosjen, Osmani ishte personi më i votuar në ato zgjedhje, me mbi 300 mijë vota. Ajo u zgjodh presidente nga Kuvendi i Kosovës në raundin e tretë të votimit, pasi mori 71 vota nga 82 deputetë sa ishin të pranishëm në seancën e zgjedhjes së saj.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, presidenti i Kosovës nuk mund t'i mbajë më shumë se dy mandate.

Zgjedhjen e presidentit Kuvendi i Kosovës duhet ta votojë me dy të tretat e votave të 120 deputetëve sa i ka gjithsej. Në rast se kandidati për president nuk i merr këto vota në dy raundet e para, në raundin e tretë zgjidhet me votat e gjysmës së deputetëve.

Formimi i qeverisë së re, Tahiri thotë se ka qenë edhe më herët situata e tillë e kur posti i kryeministrit i ka takuar partisë opozitare

PRISHTINË, 21 MARS - Një muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ende nuk ka certifikuar rezultatet E, derisa certifikimi ende nuk ka ndodhur, partitë politike dhe njohësit e këtyre çështjeve kanë filluar diskutimet rreth formimit të qeverisë së re.

Nga rezultatet përfundimtare të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje është renditur e para, me 42.30 %, Partia Demokratike e Kosovës me 20.95 % dhe Lidhja Demokratike e Kosovës me 18.37 %. Sipas këtyre rezultateve, partia LV do të ketë nevojë për një koalicion që ta formojë qeverinë e re.

Ish-kryenegociatorja për dialogun Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, në një reagim në "Facebook" ka shkruar se



blokada për krijimin e qeverisë duhet të tejkalohet për të mirën e Kosovës. Ajo ka përmendur një rast kur situata ka qenë e

ngjashme, kur posti i kryeministrit i ka kaluar partisë opozitare, ndërsa partia fituese ka marrë postin e presidentit.

"Kjo bllokadë krijimit qeverisë së re duhet të tejkalohet për të mirën e Kosovës dhe popullit - njëherë kemi pasur një situatë

të tillë, me atë rast zgjidhja ishte: posti i kryeministrit i takoi partisë opozitare që ishte fituese në mesin e opozitarëve, ndërsa partisë fituese iu dha posti i presidentit me garanci të votohej një vit pas, edhe ashtu posti i presidentes skadon një vit pas. Të gjithë partitë politike duhet të mendojnë për shtetin dhe jo vetëm për pushtetin", ka shkruar ajo.

Mes të tjerash, ajo ka pohuar se "populli foli me votë, në mënyrë demokratike, andaj të respektohet vullneti i tij, të respektohet interesi i shtetit dhe kombit". Sipas Tahirit, askush nuk do një qeveri që bëhet peng i listës së Vuçiqit.

Zgjedhjet parlamentare janë mbajtur më 9 shkurt. Procesi është vlerësuar demokratik dhe nuk janë shënuar incidente.

Ministria e Shëndetësisë: Një faktor i njohur rreziku për sindromën Down është mosha e nënës

PRISHTINË, 21 MARS - Të premtën është shënuar Dita Botërore e Sindromës Down.

Ministria e Shëndetësisë në njoftimin e saj tha se kjo ditë është një mundësi për ta rritur ndërgjegjësimin dhe për ta promovuar përfshirjen e individëve me këtë sindromë në shoqëri. "Sindroma Down është një çrregullim gjenetik që ka ndikim në zhvillimin intelektual dhe fizik, duke krijuar sfida të

mëdha për individët me këtë gjendje, të tilla si vështirësi në arsimim, punësim dhe integrim social. Statistikat globale tregojnë se 1 në 700-1000 lindje ka fëmijë me sindromën Down, dhe individët që e përballojnë këtë sindromë mund të jetojnë një jetë të plotë dhe të shëndetshme me mbështetje të duhur", thuhet në njoftim.

Po ashtu, thuhet se një faktor i njohur rreziku për sindromën

Down është mosha e nënës. "Në moshën 20 vjeç, rreziku për lindjen e një fëmije me sindromën Down është rreth 1 në 1,500, ndërsa në moshën 40 vjeç, rreziku rritet në 1 në 100", thuhet në njoftimin e MSh-së. Dita Botërore e Sindromës Down ka për qëllim luftimin e paragjyqimeve dhe promovimin e barazisë, si dhe mundësitë e barabarta për të gjithë.



BQK-ja dhe BERZH-i lansojnë nismën për mbështetjen e qasjes në financa për gratë ndërmarrëse "WE Finance Code"

EPOKA E RE
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 MARS - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Shkollës së Frankfurtit për Financa dhe Menaxhim ka lansuar - përmes një konference - nismën për mbështetjen e qasjes në financa për gratë ndërmarrëse "WE Finance Code".

Ky projekt do të ketë ndikim të qëndrueshëm në gjithëpërfshirjen financiare në vendin tonë, në pajtim me orientimet strategjike të BQK-së.

Gjatë kësaj ngjarje është nënshkruar memorandumimi i mirëkuptimit me Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK) për të shkëmbyer të dhënat mbi bizneset, veçanërisht ato që janë në pronësi ose bashkëpronësi të grave, si dhe janë nënshkruar solemnisht Letrat e Qëllimit nga institucionet që do të

mbështesin me aktivitete konkrete këtë nismë, për një gjithëpërfshirje dhe ndikim sa më domethënës në financa dhe ekonomi.

Në fjalimin hapës, guvernatori Ahmet Ismaili, ka falënderuar pjesëmarrësit duke shprehur kënaqësinë që institucionit që drejton po koordinon këtë projekt në nivel vendi, pasi që sipas tij, kjo nismë ofron një mundësi shtesë për të mbështetur qasje në financa dhe gjithëpërfshirje financiare, promovimin e mbrojtjes së konsumatorit dhe forcimi i edukimit financiar për të gjithë, me theks për qasje për gratë ndërmarrëse.

Guvernatori Ismaili ka treguar se një nga rezultatet kryesore të këtij projekti është përmirësimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë, që do të ndihmojë të kuptojmë sfidat me të cilat përballen gratë kur kërkojnë qasje në financa, veçanërisht ato që drejtojnë apo menaxhojnë Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (NVM).



Në fund, guvernatori Ismaili tha se ky projekt nuk është i rëndësishëm vetëm për BQK-në, por është thelbësor për të ardhmen e ekonomisë së vendit tonë, duke theksuar se, kur gratë fuqizohen financiarisht, ato kontribuojnë më shumë në zhvillimin ekonomik dhe krijojnë mundësi që sjellin përfitime për gjithë shoqërinë. Duke iu drejtuar të

pranishmëve, me fjalë përshëndetëse presidentja Vjosa Osmani-Sadriu e cila derisa mbështeti këtë nismë, tregoi përkushtimin e saj për të mbështetur gratë në biznes dhe për të avancuar të drejtat e tyre përmes legjislacionit dhe nismave konkrete të koordinuara me institucionet e vendit. Ndërsa shefi i BERZH-it për Kosovë, Sergiy Maslichenko, ka

falënderuar BQK-në për angazhimin për gjithëpërfshirje financiare dhe promovimin e barazisë gjinore në sektorin financiar të vendit. Gjithashtu, ai përmendi projektet kryesore që BERZH-i po zhvillon në vend, me theks tek projektet e sektorit financiar dhe bashkëpunimet e suksesshme me BQK-në.

Gjatë takimeve vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB), që janë mbajtur në vjeshtën e vitit 2024 në Washington D.C., guvernatori Ismaili dhe zëvendës-presidenti i BERZH-it, Mark Bowman, patën nënshkruar memorandumimin e mirëkuptimit lidhur me mbështetjen e qasjes në financa për gratë ndërmarrëse në kuadër të kësaj nisme.

"WE Finance Code" tashmë po zbatohet nga mbi 30 banka qendrore në vende të ndryshme në mbarë botën, përfshirë edhe vendet e rajonit, ndër to edhe Republika e Kosovës përmes BQK-së.

Kosova përmbyll dy programe me vlerë 180 milionë euro

PRISHTINË, 21 MARS - Kosova ka përmbyllur programet dyvjeçare me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), përkatësisht Programin e Aranzhimit për Gatishmëri (SBA) me vlerë 100 milionë euro dhe Programin e Resiliencës dhe Qëndrueshmërisë (RSF) me vlerë rreth 80 milionë euro.

Në një konferencë për medie, ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka theksuar se Kosova ishte shteti i parë në rajon që përfitoi nga instrumenti RSF që kishte për qëllim të mbështeste shtetet që performojnë mirë.

Me përkrahjen edhe të këtij instrumenti, Kosova lansoi ankandin e energjisë me erë, ankandin solar, si dhe finalizoi Ligjin për Energji të Ripërtërishme.

Ndërsa, SBA në anën tjetër



mundësoi ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe përshejtimin e reformave të cilat mundësuan rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Përbushja e objektivave mundëson që Kosovës t'i vihen në dispozicion pjesa e mbetur e mjeteve,

përkatësisht 16 milionë euro nga Programi SBA si dhe 10 milionë euro të tjera nga Programi RSF.

Shefi i Misionit të FMN-së në Kosovë, David Amaglobeli, ka përgëzuar Qeverinë e Kosovës dhe BQK-në për progresin thelbësor të arritur.

Amaglobeli nënvizoi stabilitetin makroekonomik të vendit duke deklaruar se Kosova ka pasur një rritje të lartë ekonomike.

Përkatësisht, ai theksoi që rritja ekonomike e Kosovës për vitin 2024 pritet të jetë nga rritjet më të larta ekonomike në Evropë.

Shefi i Misionit të FMN-së

përmendi rritjen e punësimit dhe të pagave, uljen e inflacionit në 1.6%, si dhe uljen e borxhit publik nën nivelin 17%. Gjithashtu, ai theksoi stabilitetin e sektorit financiar në Kosovë si dhe rritjen e transparencës nga BQK. Se BQK-ja ka performuar me përkushtim të lartë, u konfirmua edhe nga guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, i cili tha se ky institucion ka siguruar stabilitet financiar dhe ka realizuar objektivat strukturore dhe indikative.

Ministri Murati, shefi i Misionit të FMN-së Amaglobeli dhe guvernatori Ismaili shprehën mirënjohje të ndërsjellë për angazhimin dhe bashkëpunimin e suksesshëm deri më tani, dhe theksuan se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ministri Peci: Sektori i pyjeve ka shënuar përparim më të madh

PRISHTINË, 21 MARS - Ministri i Bujqësisë, i Pylltarisë dhe i Zhvillimit Rural, Faton Peci, tha se sektori i pyjeve në katër vitet e fundit ka shënuar përparim të madh.

Në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Pyjeve, me temën "Pyjet dhe ushqimi", ministri Peci tha se ky nuk është vlerësim i tij, por është vlerësim ndërkombëtar. "Për një

periudhë 12-vjeçare menaxhimi i pyjeve, posaçërisht parandalimi i prerjes së pyjeve, ka qenë përgjegjësi prej nivelit qendror në atë lokal, mirëpo sikur komunat nuk e kanë pasur prioritet mbrojtjen e pyjeve. Tanimë prej që ka hyrë ligji në fuqi, menaxhimi është pjesë e institucioneve qendrore. Përveç strategjisë, planeve të veprimit e task-forcës për parandalimin e

prerjeve ilegale, sektori i pyjeve duhet parë edhe në aspektin e fushëveprimtarisë dhe ndikimit që ka. Mbi 40 për qind e territorit në Kosovë është me pyje dhe kjo është një pasuri dhe trashëgimi të cilën unë e them se jemi vetëm shfrytëzues të përkohshëm, andaj historia do të na gjykojë se si do t'ia lëmë brezit të ardhshëm", tha ministri Peci.



ENTUZIASMI I MACRON: 'TASHMË KEMI NJË STRATEGJI PËR TË RIARMATOSUR PLOTËSISHT EUROPEËN'



Në Këshillin Europian të mbajtur në Bruksel, liderët konfirmuan mbështetjen për planin e Komisionit për të mobilizuar deri në 800 miliardë euro për mbrojtjen, por ekzistojnë dallime mbi disa pika kyçe.

Për Emmanuel Macronin, Këshilli Europian ishte një sukses. "Tashmë kemi një strategji për të riarmatosur plotësisht Europën, për t'u ripajisur dhe për të rimarrë plotësisht pavarësinë tonë në pesë vitet e ardhshme", shkroi presidenti francez në një mesazh të publikuar në X (ish-Twitter), në përfundim të takimit në Bruksel.

Dje, Këshilli Europian zgjati deri natën vonë, duke u mundësuar liderëve të 27 vendeve anëtare të përmbyllnin diskutimet mbi temat e ndryshme brenda një dite, dhe jo më domosdoshmërisht në dy, duke konfirmuar stilin e ri të presidentit Antonio Costa, i cili synon të shkurtojë kohëzgjatjen e këtyre takimeve dhe t'i bëjë më operative.

Plani për riarmatimin

Krerët e shteteve dhe qeverive diskutuan mbi planin ReArm Europe, ose më saktë Readiness 2030, siç është quajtur tashmë, të paraqitur nga Komisioni Europian, i cili synon të mobilizojë deri në 800 miliardë euro për blerjen e armëve dhe u bën thirrje vendeve anëtare të ndajnë burimet për projekte të përbashkëta ushtarake dhe të blejnë më shumë armë prodhuar në Europë.

Ndryshimi i emrit është një lëshim ndaj vendeve si Italia e Giorgia Meloni, e cila prej kohësh kërkonte rishikimin e emrit, të cilin e konsideronte shumë luftarak. Në këtë betejë, kryeministrja italiane gjeti një aleat të pazakontë te kryeministri spanjoll Pedro Sánchez.

"Nuk më pëlqen termi 'riarmatim'. Mendoj se BE-ja është një projekt politik i 'soft power'. Sot kemi gjithashtu detyrën e një 'hard power'. Por është thelbësore të nxjerrim në

pah pikat tona të forta në fushën e 'soft power'. Kjo është kundërshtia ime parimore ndaj termit 'riarmatim', kishte deklaruar socialisti në skajet e takimit. Por, përtej emrave, diskutimet mbi përmbajtjen vazhdojnë.

"Besoj se Europa nuk ka lëvizur kurrë kaq shpejt sa në javët e fundit", theksoi Macron, sipas të cilit "Europa ishte një komunitet i ndërtuar për të shmangur luftën, më pas një treg i vetëm. Nuk kishte ndërtuar kurrë instrumente për t'u bërë një fuqi e vërtetë. Tani po e bën. Po e bëjmë në kohë reale dhe me shpejtësi".

Qëndrime të ndryshme

Disa liderë, si kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis, e nxitën Brukselin të shkojë më tej në financimin e shpenzimeve për mbrojtjen dhe të marrë në konsideratë mundësinë e dhënies së subvencioneve për shtetet anëtare, jo vetëm kredive. Edhe kryeministrja italiane Giorgia Meloni shprehu

preferencën për "instrumente vërtet të përbashkëta europiane që nuk rëndojnë drejtpërdrejt mbi borxhin e shteteve". Të tjerë, si kryeministri holandez Dick Schoof, u shprehën kundër obligacioneve të përbashkëta, të ashtuquajturat eurobono.

Dhe kjo është linja që duket se ka dominuar në takim, pasi në deklaratat zyrtare është zhdukur çdo referencë për "eksplorimin e masave të mëtejshme" për financimin e mbrojtjes, që ishte përfshirë në përfundimet e Këshillit Europian të 6 marsit.

Koalicioni i të gatshmeve


Macron gjithashtu njoftoi një samit të ri të koalicionit të të gatshmeve për Ukrainën, i parashikuar për të enjten e ardhshme në Paris, në të cilin "do të finalizojmë punën tonë për të mbështetur ushtrinë ukrainase dhe për të ndërtuar një model ushtrie të qëndrueshme për të parandaluar pushtimet ruse", shpjegoi ai.

Takimi, në të cilin pritet të marrë pjesë edhe presidenti ukrainas

Volodymyr Zelensky, vjen pas "takimit të shefave të shtabeve të përgjithshme të ushtrive javën e kaluar në Paris dhe atij të zëvendës-shefave të

operacioneve" të mbajtur dje (të enjten, 20 mars) në Londër. Macron dhe kryeministri britanik Keir Starmer kanë punuar për të ndërtuar këtë koalicion të vendeve që mbështesin Ukrainën, që nga muaji i kaluar, kur presidenti amerikan Donald Trump nisi bisedime të drejtpërdrejta me Rusinë e Vladimir Putinin në përpjekje për të dhënë fund luftës trevjeçare.

"Kemi punuar shumë me britanikët për të përcaktuar kushtet për një armëpushim, ndaj mendoj se ky do të jetë rasti për të diskutuar dhe sqaruar këtë", deklaroi presidenti francez. "Objektivi i ardhshëm është të specifikojmë nivelet e ndryshme të mbështetjes për Ukrainën pas paqes, mbështetjen për ushtrinë ukrainase dhe vendosjen e mundshme të saj", shtoi ai. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Flamurtari është fitues i Final 4 Liga Unike Femrat

VLORË, 21 MARS - Flamurtari ka fituar sfidën finale në Vlorë kundër Peja 03 në palestrën sportive "Flamurtari" Vlorë, me 10 pikë dallim, 72:62

(20:13, 20:21, 16:21, 16:7). Ndeshja nisi më mirë për Flamurtarin, që fitoi pjesën e parë 20:13, për të vazhduar me një periudhë të dytë më të

barabartë, 20:21. Skuadrat shkuan në pushim me rezultat 40:34. Çereku i tretë ishte më i mirë për pejanet, të cilat u rikthyen dhe e fituan

periudhën 16:21, mirëpo kjo nuk ishte e mjaftueshme për ta mposhtur Flamurtarin, që triumfoi me rezultat 72:62. J. A. Johnson ishte më e mira te

Flamurtari me 16 pikë, 19 kërcime dhe tri asistime, ndërsa te Peja 03 u dallua Alexis Tolefree me 25 pikë dhe katër kërcime.

Rrahmani dhe Emërllahu: Presim të ngrihemi në Ligën B

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 MARS - Një ditë pas fitores së arritur ndaj Islandës në kuadër të "play-off"-it në Ligën e Kombeve, Përfaqësuesja e Kosovës e ka zhvilluar seancën e fundit stërvitore në Kampin Nacional në Hajvali dhe pasdite, Kosova ka udhëtuar drejt Murcias, ku do të përballet me Islandën, në ndeshjen përcaktuese të "play-off"-it për Ligën B, e cila zhvillohet ditën e diel. Në seancën e së premtes kanë marrë pjesë futbollistët që nuk ishin titullarë në ndeshjen e fundit ndaj Islandës, ndërsa pjesa tjetër e ekipit ka kryer programin e rikuperimit në hotel.



Islandës (2-1), derisa "Lewa" është optimist se "dardanët" do të kualifikohen në Ligën B. "Ndeshja e djeshme ka qenë shumë mirë e planifikuar nga ne. Po besoj se me meritë e kemi arritur këtë rezultat. Besoj se edhe në ndeshjen e dytë do ta bëjmë më të mirën dhe të kualifikohemi në Ligën

B, ku është edhe synimi ynë. Shpresoj ta arrijmë këtë qëllim. Të gjithë janë të gëzuar për momentin dhe shpresoj të vazhdojmë edhe të dielën", ka deklaruar Rrahmani. Për përballjen e zhvilluar në Prishtinë ndaj Islandës foli edhe futbollisti Lindon Emërllahu. Ai ka thënë se ishte

ndeshje e mirë nga "dardanët", derisa në Spanjë pret sërish fitore. "Ishte ndeshje mjaft e mirë, duke marrë parasysh se Islanda është ekip shumë i fortë. Në pjesën e parë luajtëm mjaft mirë, poseduam topin dhe patëm disa raste, por në pjesën e dytë ishim më cinikë para portës dhe erdhi fitorja. I falënderoj tifozët për mbështetjen! Shpresoj që edhe në Spanjë të jetë një numër sa më i madh për të na mbështetur. I kemi edhe 90 minuta të tjerë. Nuk ka mbaruar ende asgjë. Në Spanjë do të shkojmë vetëm për fitore dhe me bindje që do të avancojmë në Ligën B", ka thënë Emërllahu. Përzgjedhësi Franco Foda dhe ekipi i tij po synojnë të tregojnë një paraqitje tjetër dinjitoze, me synim të arritjes së objektivit për ngjitje në nivel tjetër në Ligën e Kombeve.


Aro Muriq dhe Donat Rudhani largohen nga grumbullimi, ftohet Faton Maloku

Portieri i parë i Kosovës, Arianet Muriq dhe mesfushori Donat Rudhani nuk do të udhëtojnë me Përfaqësuesen e Kosovës në Spanjë për ndeshjen e kthimit ndaj Islandës për shkak të lëndimeve të pësuar në ndeshjen e zhvilluar të enjten në stadiumin "Fadil Vokrri". Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se pas ekzaminimeve mjekësore është konstatuar se dy lojtarët në fjalë e kanë të pamundur të rikuperohen për ndeshjen e radhës. Ndërkohë, ekipit iu ka bashkuar portieri i Dritës, Faton Maloku. "Dardanët" të dielën përballen me Islandën.

Sonte dy ndeshje në Superligë, nesër derbi Prishtina - Trepça

PRISHTINË, 21 MARS - ProCredit Superliga vazhdon me ndeshje tejet interesante këtë fundjavë, ku zhvillohet java e 25-të. Kampionati po i afrohet fundit të garave të rregullta dhe secila ndeshje është më e rëndësishme se tjetra. Lufta për çdo pozitë në tabelë është shumë e fortë. Bora do të ndeshet me Bashkimin, ku të dyja skuadrat do të luajnë vetëm për fitore. Prishtinasit janë në vendin e shtatë me tetë

fitore dhe 16 humbje, ndërsa prizrenasit kryesojnë renditjen me 17 fitore dhe shtatë humbje. Të shtunën mbrëma zhvillohet derbi në mes të Golden Eagle Yllit dhe Pejës. Vlen të theksohet se therandasit në ndeshjen e kaluar mposhtën Prishtinën pas një ecurie shumë të mirë në Superligë. Ylli hyn në këtë ndeshje me 11 fitore dhe 13 humbje, ndërsa Peja ka 13 fitore dhe 11



humbje. Të dielën rivalët e vjetër do të përballen në Prishtinë, ku Sigal Prishtina do

të ndeshet me Trepçën në "Pallatin e Rinisë dhe Sportit". Prishtinasit kanë 15 fitore dhe nëntë humbje, duke u pozicionuar në vendin e tretë, ndërsa xehetarët janë në vendin e dytë me 16 fitore dhe tetë humbje. Proton Cable Prizreni do ta presë Vëllaznimin në një duel mjaft interesant. Proton Cable është në vendin e tetë me pesë fitore dhe 19 humbje, ndërsa Vëllaznimi gjendet në vendin e

SUPERLIGA - Java 25

Të shtunën takohen:
20:00 Bora - Bashkimi
20:00 Golden Eagle Ylli - Peja

Të dielën takohen:
20:00 Sigal Prishtina - Trepça
20:00 Proton Cable Prizreni - Vëllaznimi

pestë me 11 fitore dhe 13 humbje.

Skuadrat favorite presin fitoret e radhës

PRISHTINË, 21 MARS - Gara në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt) vazhdon me ndeshjet e xhiros së 23-të. Të shtunën prej orës 20:00 janë dy ndeshje, ndërsa një ndeshje, në termin të njëjtë, është të dielën. Skuadrat e kreut të tabelës nuk presin të kenë

telashe për të fituar dy pikë të reja. Lideri Rahoveci e pret Vushtrrinë të shtunën. Rahoveci ka 22 fitore rresht dhe udhëheq në tabelë me 44 pikë. Vushtrria është e pesta me 14 pikë. Të shtunën është edhe ndeshja Llapi - Kastrioti, ndërsa skuadra ferizajase

llogaritet favorite. Llapi është i gjashti me 11 pikë, ndërsa Kastrioti i treti me 34 pikë. Xhiroja mbyllet me ndeshjen Besa Famgas - Prishtina të dielën. Besa do të mundohet të reagojë pas disfatës së thellë nga Rahoveci. Ndërkohë prishtinasit udhëtojnë në Pejë

me shpresë për befasi. Besa është e dyta me 34 pikë, ndërsa Prishtina e katërta me 23. Në Ligën e Parë është java e dhjetë. Deçani - Prizreni (19:30) dhe Istogu - Drita (14:00) janë ndeshjet e së shtunës. Të dielën prej orës 14:30 është takimi Vëllaznimi - Ulpiana.



Ronaldo për herë të parë tregon pse nuk është martuar ende me Georginan

LISBONË, 21 MARS - Futbollisti i famshëm Cristiano Ronaldo ka adresuar spekulimet mbi martesën me partneren e tij prej vitesh, Georgina Rodriguez. Dyshja janë në një lidhje dashurie që nga viti 2016 dhe kanë ndërtuar një familje të madhe së bashku, por ende nuk kanë zyrtarizuar

bashkimin e tyre. Në dokumentarin e Netflix "I Am Georgina", Ronaldo theksoi se martesë është një vendim i përbashkët: Ndërkohë, Georgina ka treguar se miqtë e saj shpesh bëjnë shaka me këngën e Jennifer Lopezit "The Ring", duke e pyetur kur do të vijë unaza e shumëpritur.

Spekulimet u shtuan edhe më shumë kur, gjatë një fjalimi në "Globe Soccer Awards", Ronaldo iu referua Georginës si "gruaja ime", duke ngritur dyshime për një martesë sekrete. Së bashku ata kanë dy vajza biologjike, Alana Martina dhe Bella Esmeralda, ndërsa Georgina është gjithashtu

njerka e përkushtuar për tre fëmijët e tjerë të Ronaldos: Cristiano Jr. dhe binjakët Eva dhe Mateo. Raportet sugjerojnë se ajo është regjistruar ligjrisht si nëna e të pesë fëmijëve, duke rritur pritshmëritë se çifti do ta kurorëzojë dashurinë e tyre shumë shpejt.



Bardhi: Duam ta vazhdojmë serinë e fitore kundër Lihtenshtajnit

VADUZ, 21 MARS - Përfaqësuesja e Maqedonisë së Veriut në futboll të shtunën me fillim nga ora 15:00 në Vaduz të Lihtenshtajnit do ta luajë ndeshjen e parë kualifikuese për Botërorin kundër vendasve. Përfaqësuesja e Maqedonisë të enjten ka mbërritur në Vaduz, ndërsa të premtën e ka zhvilluar seancën e vetme stërvitore dhe zyrtare para ndeshjes. Para kësaj ndeshje në konferencën për shtyp foli kapiteni Enis Bardhi. "Ngushëllime për familjet, për viktimat! Kjo tregon se jeta është një e panjohur. Ne nuk e dimë se çfarë na pret nesër. Prandaj është shumë e rëndësishme të jetojmë çdo moment dhe të kujdesemi për të gjithë rreth nesh. Sigurisht, ne duam të vazhdojmë atë seri ndeshjesh të mira dhe fitore jo vetëm kundër Lihtenshtajnit, por edhe kundër të tjerëve. Do ta japim maksimumin që në minutën e parë të duelit të nesërm", ka



thënë kapiteni Bardhi. Ndërsa trajneri Bllagoja Milevska ka vlerësuar se kjo ndeshje është e vështirë, por ka paralajmëruar se synohet të vazhdohet me fitore. "Është ende shumë e vështirë për mua të flas për gjithçka që ndodhi. Edhe një herë, ngushëllimet e mia për viktimat! Ju kërkohet të përqendrohemi në çështjet e futbollit, sepse tani është e vështirë për mua të flas për ndonjë gjë tjetër përveç futbollit.

Sigurisht, ne kemi ardhur për të vazhduar atë seri fitoresh. Por ne këtë mund ta bëjmë vetëm nëse i përkushtohemi kësaj ndeshjeje në maksimum", ka deklaruar trajneri Milevska. Për shkak të tragjedisë në Koçan, ku humbën jetën 59 persona dhe kur ndeshja të luhet në Vaduz do të jetë ende ditë zie në Maqedoni, skuadra ka vendosur të paraqitet me fanella të zeza për të treguar respekt për të vdekurit në tragjedi.

Lakersat pëson humbje nga Milwaukee, Golden State mposht Toronton



LOS ANXHELOS, 21 MARS - Skuadra e Milwaukee arriti një fitore të rëndësishme ndaj Lakersave me shifrat 118-89, duke u ngjitur në vendin e pestë në Lindje. Antetokounmpo me 28 pikë ishte lider në fushë për Bucksin, ndërkohë që te

lakersat u ndje shumë mungesa e Jamesit dhe Donçiqit. Fitore të vështirë korri në sekondat e fundit ekipi i Golden States, që mundi me rezultat 117-114 Toronton. Gjashtë lojtarë të skuadrës së Warriorsit realizuan mbi 10

REZULTATET

Charlotte - New York	115-98
Indiana - Brooklyn	105-99
Golden State - Toronto	117-114
Sacramento - Chicago	116-128
Lakers - Milwaukee	89-118

pikë (Green me 21 pikë më i miri), duke i bërë të pavlefshme 29 pikët e Barnesit për kanadezët. Rikthehet te sukcesi ekipi i Chicagos, që mposhti me rezultat 128-116 Sacramenton jashtë fushës, ku protagonist ishte Coby White me 35 pikë. Indiana mundi me rezultat 105-99 Brooklynin falë 51 pikëve të dyshes Mathurin-Turner, ndërsa Charlotte triumfoi me shifrat 115:98 ndaj New York (Ball 25 pikë).

Raphinha: Flick ma ndryshoi jetën

Ylli brazilian i Barcelonës, Raphinha, ka treguar se vendimi i tij për të qëndruar në klub këtë sezon është ndikuar fuqishëm nga trajneri Hansi Flick. Në një deklaratë të fundit, ai ka rrëfyer bisedën

vendimtare që pati me gjermanin para fillimit të sezonit. "Hansi Flick ma ndryshoi jetën. Ai më telefonoi dhe më kërkoi të vija në stërvitje para se të merrte një vendim, sepse donte të

fliste me mua dhe më bëri të ndihem i rëndësishëm në planet e tij", u shpreh Raphinha. Anëtori brazilian, i cili është përfolur për një largim të mundshëm gjatë merkatos së verës, pranoi se

kjo qasje e Flickut ishte një pikë kyçe në vendimin e tij për të qëndruar në "Camp Nou". "Ky ishte momenti që ndryshoi gjithçka për mua. Fola me gruan time dhe i thashë: Nëse ky njeri është i

drejtë dhe sheh përpjekjen që bëj në stërvitje, unë do ta bëj të më dëshirojë brenda një jave dhe nuk do të pendohet. Dhe mendoj se kisha të drejtë", ka përfunduar Raphinha.

SHKURT

Rahoveci fiton bindshëm derbin ndaj Besës

Vetëm në pjesën e parë të ndeshjes Rahoveci - Besa Famgas kishte rivalitet. U zhvillua lojë e fortë dhe e barabartë në 30 minutat e parë. Skuadra pejana u shkëput në dy gola, por në minutat e fundit "vreshtarët" u shkëputën në tri gola. Ndërkohë pjesa e dytë e ndeshjes u dominua plotësisht nga Rahoveci që në fund fitoi 41:30. Rahoveci ka 22 fitore rresht dhe udhëheq në tabelë me 42 pikë. Besa Famgas e pësoi humbjen e pestë. I ka edhe 17 fitore dhe renditet e dyta me 34 pikë.

Hamiltoni, më i shpejti në kualifikueset e garës sprint në Kinë


Lewis Hamiltoni do ta nisë nga vendi i parë garën sprint që do të zhvillohet mëngjesin e së shtunës në Kinë. Piloti britanik i Ferrarit dha sot kohën më të shpejtë, 1:30:849, duke lënë pas Max Verstappenit me Red Bullin. Një paraqitje e shkëlqyer e "kokëkuqes", që ishte krejt ndryshe nga makina e një jave më parë në Australi. Në vendin e tretë u rendit Oscar Piastrri me Mc Larenin, ndërsa në vendin e katërt u rendit Charles Leclerc me makinën tjetër Ferrari. Në vendin e pestë u rendit George Russell me Mercedes, që la pas Lando Norrisin (i gjashti), fitues i garës së parë. Në "top 10" më të mirët edhe Kimi Antonelli, Yuki Tsunoda, Alexandre Albon e Lance Stroll.

Calhanoglu këshillon Gulerin t'i bashkohet Interit

Hakan Calhanoglu ka thënë se dëshira e tij e madhe është që Arda Guler t'i bashkohet Interit. Calhanoglu me pas ka deklaruar se bashkëkombësi i tij duhet të të shkojë në një klub ku mund të luajë më shumë. "Arda Guler është një lojtar shumë i rëndësishëm, një vëlla për të cilin më intereson shumë. Do të doja që ai të vinte dhe të luante me ne në Inter. Këshilla ime është që ai të shkojë atje ku merr më shumë kohë, ai e meriton atë", ka thënë Calhanoglu. "Të gjithë duan lojtarë cilësorë. Unë nuk e di se si po shkojnë gjërat për të në Real Madrid, kështu që nuk dua të përfshihem shumë. Shpresoj që ai të luajë më shumë sepse e meriton", ka përfunduar Calhanoglu.

Odegaard: Vinicius është më i miri në botë, do ta doja tek Arsenali

Kapiteni i Arsenalit, Martin Odegaard, ka pranuar se ai do të donte që "topçinjtë" ta merrnin Vinicius Juniorin nga Real Madridi. Duke folur për mediet, Odegaard u pyet se cili ishte, sipas tij, lojtari më i mirë në botë. Ish-ylli i Realit, i cili u largua nga "Bernabeu" më 2021, ka thënë: "Lojtari më i mirë në botë? Vini Jr". Arsenali do të përballet me Real Madridin në çerekfinalin e Ligës së Kampionëve sezonin e ardhshëm. Odegaardi është pyetur se cilin nga yjet e "LosBlancos" do të merrte në "Emirates". Përgjigjja e tij ka qenë: "Një lojtar që do të merrja tek Arsenali nga Real Madridi? Bini Jr".



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Akicuki Group” SH.P.K. me seli në Vushtrri, Ardian Shallci ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 812236637 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Akicuki Group” D.O.O. Vushtrri, Ardian Shallci donelo odluku o prestani rada sa nr. 812236637 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Akicuki Group” L.L.C. with headquarters Vushtrri, Ardian Shallci has come to the decision to quit its business: 812236637 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Lirimi” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810775562. rëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Jeton Demiri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore nga klasa 1 deri 8 "Zenum Çoçaj" në Gjonaj.
- Avdi Arifi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Visar Junuzi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë, drejtimi Tregti.
- Marash Dedaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 të sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Erëblina Zymeri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. si dhe diplomën e Gjymnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Behar Q. Mehmeti B.I. shpall të pavlefshme nr. Unik të Biznesit: 812091437 të lëshua nga ARBK.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas mar-
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA

1992

